



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 295/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Lazic, dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Levizjes Vetvendosje (LVV) dega në Prizeren, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizeren, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 11.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Levizjes Vetvendosje (LVV) dega në Prizeren.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 09.06.2014 ka pranuar një ankesë nga Levizja Vetvendosje dega në Prizeren, në të cilën ankesë pretendohet se me datë 08.06.2014 rreth orës 09:30, aktivistja nga radhet e LVV-së, Alisa Hasani ka vërejtur se në afersi me pak se 100 metra afër Gjimnazit “Gjon Buzuku”, ishte i vendosur posteri i kandidatit për deputet Irfan Fusha nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Andaj me këtë veprim është bërë shkelje e Nenit 7.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, si dhe Neni 36. pika b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, pretendohet në ankesën e LVV-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë pesë fotografi nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:


ankesa është e pabazuar

Ne bazë të provave të ofruara nuk mund të identifikohet se objekti që pretendohet në ankesë ka qenë Qendër e Votimit, ngase nuk asnjë element identifikues që mund të vërtetohet nga shkresat e lëndës së objekti në fjalë është QV. Andaj, PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në provë relevante, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në Nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet”, lidhur me ankesën e lart përmendur vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 295/2014 më datën 11.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është me e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.